

## *Raporti vjetor 2019*



## ***Përmbajtja***

<i>Lista e Shkurtesave</i> .....	3
<i>Fjala e Drejtores së Përgjithshme</i> .....	4
1. <i>Korniza ligjore dhe operationale</i> .....	5
2. <i>Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës</i> .....	6
3. <i>Përshkrimi i aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2019</i> .....	7
4. <i>Trajnimet</i> .....	13
5. <i>Realizimi i buxhetit për vitin 2019</i> .....	14
6. <i>Promovimi i rëndësisë së akreditimit</i> .....	14
7. <i>Projektet mbështetëse për DAK-në</i> .....	15
8. <i>Bashkëpunimet ndërkombëtare</i> .....	16
9. <i>Objektivat dhe aktivitetet e DAK-së në të ardhmen</i> .....	17
<i>Laboratorët testuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës</i> .....	18
<i>Trupat Inspektues të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës</i> .....	19

## *Lista e Shkurtesave*

DAK - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

TVK - Trupa për Vlerësim të Konformitetit

KA - Këshilli i Akreditimit

KP - Këshilli Profesional

EA - European Co-operation for Accreditation (Korporata Evropiane e Akreditimit)

ILAC - International Laboratory Accreditation Cooperation (Korporata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve)

IAF - International Accreditation Forum (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit)

MAC - Multilateral Agreement Council ( Këshilli për Marrëveshje Multilaterale)

MLA - Multilateral Agreement ( Marrëveshje Multilaterale)

FMG - Free Movements of Goods (Lëvizja e Lirë e Mallrave)

SIDA - Suedish International Development Cooperation Agency ( Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar)

QI - Quality Infrastructure (Infrastruktura e Cilësisë)

LT - Laboratorët Testues

LK - Laborator Kalibrues

TI - Trupa Inspektues

ISO - International Organization for Standardization ( Organizata Ndërkombëtare për Standarde)

IEC - International Electrotechnical Commission (Komisioni Ndërkombëtar për Elektroteknik)

## *Fjala e Drejtores së Përgjithshme*



*Në vitin tim të parë si Drejtore e Përgjithshme, kam kënaqësinë të raportoju që viti 2019 shënoi një vit të suksesshëm për DAK-në, duke u vlerësuar me ngritje të performancës operationale dhe strategjike. Fokusi ynë ishte përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve, ruajtja e integritetit, si dhe ngritja e profilit dhe ndikimit të Akreditimit në Institucionet Qeveritare dhe palët tjera të interesit. Kam nderin që të arriturat dhe sfidat e Drejtorisë së Akreditimit t'i paraqes përmes publikimit të këtij raporti vjetor. Raporti përmban një pasqyrë të përgjithshme të veprimtarisë së DAK-ut, së bashku me një vlerësim të detajuar të aktiviteteve për vitin 2019.*

*Viti 2019 për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës është karakterizuar me një rritje të theksuar të aktiviteteve të akreditimit, zgjerim të skemave të akreditimit, plotësim të infrastrukturës ligjore dhe ngritje të kapaciteteve njerëzore. Institucionet shtetërore kanë rritur cilësinë e shërbimeve për bizneset dhe konsumatorët përmes ndryshimit të politikave duke e bërë akreditimin të obligueshëm për ofruesit e shërbimeve. Në këtë mënyrë Institucionet Shtetërore i kanë besuar Drejtorisë së Akreditimit me më shumë detyra dhe përgjegjësi. Rritja e kërkesave për shërbime të akreditimit ka ndikuar edhe në rritjen e vetëdijesimit për rolin dhe rendësin e akreditimit.*

*Padyshim që këto të arritura nuk do të ishin të mundura pa përkushtimin dhe angazhimin e stafit të DAK-së, eksperteve teknik, anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe Këshillit Profesional, TVK-ve dhe kolegëve nga njësitë tjera të Ministrisë, për punën e të cilëve jam shumë mirënjohëse dhe falënderuese. Një falënderim dhe mirënjohje të veçantë për kabinetin e Ministrit z. Shala, stafin e projektit FMG II –BE, WB dhe LuxDevelopment.*


*Gentiana Islamaj  
Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës*

## 1. Korniza ligjore dhe operationale

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) funksionon në bazë të Ligjit Nr. 05/L-117. Ky ligj është në pajtim të plotë me Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 e cila përcakton kërkesat për akreditim dhe mbikëqyrjen e tregut dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 339/93 për aq sa ka të bëjë me akreditimin.

Sistemi i Menaxhimit të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës është në përputhje të plotë me kërkesat e standardin EN ISO/IEC 17011.

*“Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës është i vetmi Trup Kombëtar i Akreditimit, i njohur me ligj, për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit që kryejnë aktivitete të tilla si: testim, kalibrim, certifikim, dhe inspektim qofshin në sektorët publik apo privat, të fushës vullnetare apo të detyrueshme”*




## 2. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

Organet e DAK janë: Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli Profesional dhe Këshilli i Akreditimit. Këshilli Profesional dhe Këshilli i Akreditimit janë organe ndihmese të DAK-së, të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë paanshmëri, transparencë dhe barazi gjatë procesit të akreditimit.



### Organogrami i DAK



### 3. Përshkrimi i aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2019

- Në drejtim të kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe operacionale të akreditimit, gjatë vitit 2019 është hartuar Sistemi i Menaxhimit sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17011:2017. Ky sistem përbehet nga njëqindnjëzetënjë (121) dokumente (politika, procedura, instruksione dhe forma) të hartuara në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në gjuhën angleze.
- Gjithashtu, është dizajnuar Logo e re e akreditimit, e cila është fuqizuar përmes Udhëzimit Administrativ nr.04/2019 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimin e Logos së DAK dhe Simbolit të Akreditimit, hyrë në fuqi me datë 28.05.2019.



*Kuptimi i Llogos: ngjyra e kaltër simbolizon besimin, besnikërinë, që në këtë rast lidhet edhe me vetë kuptimin e fjalës **Accredit** që do të thotë dhënie e besimit. Kombinimi i ngjyrave është kaltër dhe verdhe është ndërlidhje më ngjyrat e flamurit shtetëror të Republikës së Kosovës.*

- Është draftuar Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të DAK-ut, dhe bazuar në procedurat administrative Rregullorja është përcjelle në Ministrinë e Administratës Publike për Shqyrtim dhe Verifikim ligjore të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë me politikat zhvillimore të administratës publike.
- Komfor ndryshimeve në standardin ISO/IEC 17025:2017, DAK ka hartuar politiken e tranzicionit, me që rast janë njoftuar të gjitha palët e interesit, dhe është filluar me implementimin e këtij standardi që nga Shtatori/2019.
- Në përputhje me kërkesat e EA-së dhe standardeve të akreditimit, janë hartuar dhe miratuar dokumentet “Instruksionet mbi operimin dhe detyrat e Komiteteve Teknikë” dhe në fillim të vitit të ardhshëm pritet të themelohen Komiteti Teknik për Laboratorët Testues dhe Komiteti Teknik për Trupat Inspektues.
- Me qëllim që të krijojmë lehtësira për bizneset-Trupat për Vlerësim të Konformitetit, kemi hartuar Procedurën e Gjurmueshmërisë së Matjeve dhe Procedurën e Testeve të Zotësisë,

përmes së cilës mundësohet njohja e certifikatave të kalibrimit të AMK-së për pajisjet e Vëllimit, Masës dhe Termometrisë. Me këtë veprim, përpos që ju është mundësuar TVK-ve të kryejnë shërbimet e kalibrimit brenda Kosovës me kosto më të ulët dhe në kohë më të shpejt, gjithashtu ky aktivitet do të kontribuoj në promovimin e akreditimit dhe metrologjisë kosovare.

- Gjatë vitit 2019 numri i stafit të DAK-së është rritur në tetë (8) dhe njeherit është kompletuar edhe gjithë struktura organizative duke u plotësuar katër (4) pozitat e lira me staf kompetent dhe profesional në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011:2017.
- Është zgjeruar lista e vlerësuesve dhe eksperteve teknik të DAK-së, duke shtuar numrin e tyre në shtatëdhjetetë (78). Përfshirja e këtyre eksperteve në procesin e akreditimit kontribuon në rritjen e profesionalizmit dhe ekspertizës duke rezultuar me implementimin e duhur të politikave dhe ngritjen e përgjithshme të performances në DAK.



- Në kuadër të aktiviteteve të akreditimit, me qëllim të rritjes së kompetencës së vlerësuesve vendor dhe përmirësimit të procesit të akreditimit, DAK në bashkëpunim me projektin CERP të BB, ka arritur që të zhvilloj procedurat dhe të përzgjedh tre (3) vlerësues ndërkombëtar të cilët do të angazhohen në proceset vlerësuese të TVK-ve vendore dhe njeherit do të shërbejnë si trajnues për stafin lokal.



- Me qëllim që të sigurohet paanshmëria, transparencja dhe barazia gjatë procesit të akreditimit është themeluar dhe funksionalizuar Këshilli Profesional i Akreditimit. Ky Këshillë përbehen me anëtare nga të gjitha palët e interesit dhe në mesin e shumë detyrave dhe përgjegjësive, ofrojnë këshilla dhe rekomandime për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit. Gjatë vitit 2019, Këshilli Profesional i Akreditimit ka mbajtur dy takime, ku ndër tjera anëtarët e KP kanë miratuar dymbëdhjetë (12) politikat e reja të akreditimit.




- Këshilli i Akreditimit në kuadër të funksioneve dhe detyrave të tij ka mbajtur gjithsejtë dymbëdhjetë (12) takime, ku janë shqyrtuar gjashtëmbëdhjetë (16) lënde të TVK-ve, janë ekzaminuar të gjeturat dhe dokumentet dhe janë dhënë rekomandimet për akreditimin e tyre.

- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) gjatë vitit 2019, jo vetëm që arriti të përmbushë me sukses objektivat e përcaktuara në planin e punës, por gjithashtu arriti të ngris edhe dy (2) skema të reja të akreditimit. Është ngritur skema e re të akreditimit për trupat certifikues për produkte ndërtimi. Kjo skemë është ngritur më qëllim që DAK të jetë e gatshme për t’iu përgjigjur kërkesave të TVK që operojnë në këtë fushë dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga miratimi i Ligjit për produkte të ndërtimit.
  
- Në kuadër të objektivave të MTI-së për mbrojtjen e konsumatorit, dhe bazuar në faktin që laboratorët mjekësor në Kosovë janë një fushë shume e ndjeshme dhe kritike, është ndërmarrë iniciativa për të bërë të detyrueshëm akreditimin e laboratorëve mjekësor. Kjo me qëllim që laboratorët mjekësor të operojnë më rregulla të qarta, staf kompetent dhe të prodhojnë rezultate/analiza të sakta. Kemi ngritur skemën e re të akreditimit për laboratorët mjekësorë, duke trajnuar stafin e brendshëm dhe ekspertet e jashtëm me standardin ISO 15189, duke hartuar politikat ,procedurat dhe dokumentet përkatëse.




- Në drejtim të vlerësimit të kompetencës së TVK-ve, DAK ka vazhduar me procesin e mbikëqyrjeve të rregullta të TVK-ve, duke dhënë besimin dhe siguruar palët e interesit që TVK-të kanë bërë plotësimin e vazhdueshëm të kërkesave të standardeve përkatëse gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre specifike për vlerësimin e konformitetit.
- Vlen të theksohet që gjatë këtij viti, DAK ka shënuar progres edhe në numrin e përgjithshëm të akreditimeve. Krahasuar me vitin paraprak, numri i akreditimeve në vitin 2019 është rritur për 20 %, duke rritur numrin e përgjithshëm të Trupave për Vlerësim të Konformitetit (TVK) të akredituara në pesëdhjetekatër (54).


1. Paraqitja grafike e aktiviteteve të DAK gjatë vitit 2019



## 2. Laboratorët testues të akredituar sipas fushave



## 3. Trupat inspektues të akredituar sipas fushave



#### 4. Trajnimet

Në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së nivelit të kualifikimit dhe kompetencës së stafit të DAK-së dhe vlerësuesve/eksperteve teknik, dhe me qëllim krijimin e një sistemi kombëtar të akreditimit në përputhje me kërkesat e EA-së, DAK ka organizuar katër (4) trajnime, si në vijim:

- *ISO/IEC 17065 për trupa certifikues për produkte të ndërtimit (26 pjesëmarrës)*
- *Akreditimi për qëllime të autorizimit (25 pjesëmarrës)*
- *ISO 15189 për laboratorët mjekësor (22 pjesëmarrës)*
- *Procedurat e akreditimit për anëtarët e Këshillit Profesional (13 pjesëmarrës).*



Gjithashtu, gjatë vitit 2019, janë mundësuar dy (2) vizita të katër (4) vlerësuesve të DAK-së në proceset e vlerësimit për akreditim zhvilluar nga:

- Agjencia Sllovene e Akreditimit-vlerësimi i laboratorit testues dhe trupës inspektuese në Institutin e Elektros
- Agjencia Kroate e Akreditimit- vlerësimi i laboratorit testues për analiza bujqësore.

## 5. Realizimi i buxhetit për vitin 2019

- Buxheti i aprovuar i DAK-së për vitin 2019 ishte 87,841.94 euro, i shpërndarë në 7 nënkategori ekonomike. Realizimi i buxhetit për këtë vit arriti përqindjen prej 98.29%. Vlen të theksohet se disa nga aktivitetet e DAK-së janë mbuluar nga projekti FMG II dhe Lux Development.

## 6. Promovimi i rëndësisë së akreditimit

- Me datë 10 Qershor është organizuar Dita Botërore e Akreditimit. Eventi jo vetëm që pati rolin e promovimit të rëndësisë së akreditimit por njeherit edhe të diskutimeve të cilat i shërbyen DAK-ut dhe palëve të përfshira në procesin e akreditimit, si udhërrëfyes për punën e mëtutjeshme dhe rritjen e performances. Gjithashtu, DAK ka përgatitur videon promovuese në dy gjuhët zyrtare “Akreditimi-vlerë e shtuar në zinxhirët e furnizimit” e cila është shfaqur gjatë eventit dhe është publikuar në ueb faqen e DAK-së.



- Në kuadër të aktiviteteve promovuese, DAK ka marr pjesë në dy (2) konferenca/punëtori të organizuara nga Agjencia e Forenzikes së Kosovës dhe Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, me që rast është bërë prezantimi mbi rëndësinë dhe procesin e akreditimit.

## 7. Projektet mbështetëse për DAK-në

- “Lëvizja e Lirë e Mallrave” (*Free Movement of Goods II -FMG II*), mbështetur nga zyra e BE-së në Kosovë - Zyra e BE-së në Kosovë, përmes projektit FMG II, ka për qëllim të mbështesë Qeverinë e Kosovës për të zhvilluar më tutje kapacitetet institucionale për të krijuar një bazë për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me acquis të BE-së dhe kërkesave të MSA-së. Përfituese e këtij projekti është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ku gjatë vitit 2019 kemi siguruar mbështetjen teknike në kompletimin e legjislacionit sekondar të akreditimit dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore përmes pjesëmarrjes në punëtori, trajnimeve nga ekspertet ndërkombëtar si dhe mbështetjes financiare për pjesëmarrje në takimet e EA-së. Ky projekt do të vazhdoj edhe për dy vitet në vijim.
- “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor” (*Quality Infrastructure for Western Balkans - QI*), mbështetur nga SIDA - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, vazhdon të mbetet pjesë e projektit “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor”, kryesisht mbështetje teknike përmes trajnimeve që ndërlidhen me fushën e akreditimit.
- “Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për eksport” – Banka Botërore - Ky projekt ka për qëllim zgjerimin e mjedisit të të bërit biznes dhe gatishmërisë së eksportit, mbështetjen e njohjes ndërkombëtare të Infrastrukturës Kosovare të Cilësisë dhe reformimin e sistemit të inspektimeve të biznesit. Ky projekt do të mbështes DAK për t’u kualifikuar për anëtarësim në organizatat evropiane dhe koordinim me sektorët tjerë të IC -për qëndrueshmërinë e një sistemi IKC.

## 8. *Bashkëpunimet ndërkombëtare*

- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës, edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar të ketë marrëdhënie të mira bashkëpunimi me të gjitha Trupat Akreditues të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive, si dhe shfrytëzimi i ndërsjellët i eksperteve teknik në procese të vlerësimit për akreditim, kanë qenë aktivitete të realizuar si rezultat i këtyre bashkëpunimeve.
  
- DAK vazhdon të jetë anëtare shok në ILAC (International Laboratory Accreditation Co-operation), anëtare e IAF (International Accreditation Forum), dhe anëtare shok në EA (European co-operation for Accreditation). Përfaqësuesit e DAK-së kanë marr pjesë në takimet të ndryshme të EA-së dhe Këshillit për Marrëveshje Multilaterale (Multilateral Agreement Council- EA MAC).

Marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU) të DAK-së me Trupat Akredituese Rajonale:

- *MoU me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit-Shqipëri (DPA)*
- *MoU me Institutin e Akreditimit të Maqedonisë (IARM)*
- *MoU me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK)*
- *MoU me Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA)*
- *MoU me Trupin Akreditues të Rumanisë (RENAR).*



## 9. Objektivat e DAK-së në të ardhmen

Objektivat e DAK-së për vitin 2020 do të jenë:

- Zgjerimi i fushave të akreditimit
- Digjitalizimi i procesit të akreditimit
- Ngritja e performances së DAK-së
- Aplikimi për MLA me EA

Për fund, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit falënderon të gjithë bashkëpunëtorët që kontribuan në rritjen e performances, transparencës, gjithë-përfshirjes dhe llogaridhënies, duke shpresuar që ky përkushtim do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Informacione më të detajuara mbi procedurat, dokumentacionin dhe ndryshimet në nivel ndërkombëtar mbi akreditimin, mund ti gjeni në ueb-faqen e DAK-së <http://dak.rks-gov.net/>.

*Laboratorët testuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës*

<i>TVK</i>	<i>Fusha e Akreditimit</i>
<i>Instituti Bujqësor i Kosovës-MBPZHR</i>	<i>Laboratori analitik dhe laborator i farërave</i>
<i>Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale</i>	<i>Laboratori për kontrolle të cilësisë së produkteve dhe pajisjeve medicinale</i>
<i>KRU "Gjakova" SH.A.</i>	<i>Laboratori fiziko-kimik dhe bakteriologjik i ujit</i>
<i>KUR "Prishtina" SH.A.</i>	<i>Laboratori testues i ujit</i>
<i>"SIERRA LAB" SH.P.K.</i>	<i>Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të naftës</i>
<i>"Kosova-Lab" SH.A.</i>	<i>Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës</i>
<i>N.SH "ETL-KOSOVA"</i>	<i>Laboratori për ekzaminimin e materialeve ndërtimore dhe shqyrtimin e konstruksioneve</i>
<i>N.P. "IPE-PROING"</i>	<i>Laboratori për analiza fiziko-mekanike i materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit</i>
<i>N.SH "AGROVET"</i>	<i>LT i materialeve agrogjeologjike, agrogjeologjike, teknologjike, ushqim dhe ujë</i>
<i>N.SH. "TEST&amp;ING"</i>	<i>Laboratori i përzierjeve bituminoze dhe hulumtimeve gjeomekanike</i>
<i>"ACT-ing" SH.P.K</i>	<i>Laboratori i materialeve ndërtimore</i>
<i>SH.A. "Birra Peja"</i>	<i>Laboratori qendror i analizave kimike dhe mikrobiologjike të birrës, ujit dhe lëngjeve</i>
<i>"Ex Fis LABS" SH.P.K</i>	<i>Laboratori për analiza të derivateve të naftës</i>
<i>Instituti "INKOS"</i>	<i>LT për elektrik, naftë, dhera dhe ndikim mjedisi</i>
<i>"Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë"</i>	<i>Laboratori i ushqimit dhe veterinarisë së Kosovës</i>
<i>"ADEA GROUP" SH.P.K.</i>	<i>Laboratori testues i ujit</i>
<i>"STONE CASTLE" L.L.C.</i>	<i>Laboratori për testimin e parametrave fiziko-kimike të verërave dhe pijeve të forta alkoolike</i>
<i>N.P.N "AK-COMPANY" SH.P.K.</i>	<i>Laboratori i testimit të betonit dhe përzierjes bituminoze</i>
<i>DVV-MBPZHR</i>	<i>Laboratori i testimit të verërave</i>
<i>"EUROLAB" SH.P.K</i>	<i>Laboratori i kontrollimeve teknike të automjeteve</i>
<i>NTP „Ballkan Petrol“</i>	<i>Laboratori për analiza të vajrave</i>
<i>NPT"FERPLAST"</i>	<i>Laboratori për kontrollimin e masave plastike</i>
<i>G&amp;B "Tamponi"SH.P.K.</i>	<i>Laboratori i materialeve ndërtimore</i>
<i>IKSHPK-Qendra e Laboratorëve Testuese</i>	<i>Laboratori bioteknologjikë; Laboratori mikrobiologjik i analiza te ujit dhe ushqimit; Laboratori i analizave organike ujit dhe ushqimit; Laboratori i analizave fiziko kimike te ujit ,ujit ambalazhuar dhe ujërave rekreativ; Laboratori për identifikimin e metaleve të rënda ne Ujë; Laboratori bromatologjisë parametrat fiziko kimik te artikujve ushqimor</i>
<i>„IPE CONTROLS-ING“ SH.P.K</i>	<i>Laboratori për analiza fiziko-mekanike të materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit</i>
<i>"IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K</i>	<i>Laboratori për shqyrtimin e materialeve ndërtimor, hulumtimeve gjeologjike dhe gjeomekanike, matjet elektrike, seizmike, ambienti dhe uji</i>
<i>"M&amp;Silloi" Sh.P.K</i>	<i>Laboratori i vetive kimike të grurit, miellit, himeve dhe brumërave - M&amp;S LABORATORY</i>

IMN"Test-Beton" SH.P.K	Laboratori për ekzaminimin e materialeve ndërtimore beton, asfalt dhe agregate
Agjencia e Kosovës për Forenzikë - AKF	Laboratori i ADN/Serologji; Laboratori për analiza kimike të narkotikëve; Laboratori i balistikës; Laboratori i dokumenteve dhe dorëshkrimeve; Laboratori i daktiloskopisë dhe traseologjisë; Laboratori për analize të eksploziveve dhe zjarrëvenjeve
"EUROPE SYSTEMS" L.L.C	Laboratori i matjeve elektrike
"E&A Engineering Consulting" SH.P.K	Laboratori i analizave të derivateve të lëngëta të naftës
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Laboratori për kontrollin teknik të automjeteve dhe shtypja e VIN Numri
"Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji-UBT" SH.P.K	Laboratori i materialeve ndërtimore
"Trepfarm" SH.P.K	Laboratori për testimet Farmaceutike dhe Ushqimit "Trepfarm Laboratory"
Korporata "Sara&Meti" Sh.p.k	Laboratorit analitik, bujqësor dhe i ushqimit
"FERTEST" sh.p.k	Laboratori për testimin e materialeve të ndërtimit
Geokos A & A O.P	Laboratori për testimet gjeomekanike
NSH "IBMS"	Laboratori për materialet e ndërtimit dhe strukturat

### Trupat Inspektues të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës

<b>TVK</b>	<b>Fusha e akreditimit</b>
"Saybolt Pan Ardiatika" d.o.o, Jedinica Kosovo	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së karburanteve të lëngëta të naftës, inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuara të naftës
"Dilloni Benz" N.T.SH.	Inspektimi për homologim të automjeteve të kategorive L,M,N dhe O, si dhe të gjitha nënkategoritë e tyre
"Kastrati" SH.P.K.	Inspektimi për homologim të automjeteve të kategorive L,M,N dhe O si dhe të gjitha nënkategoritë e tyre
"Unika Inspekt" SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës, inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuar të naftës, verifikimi i mjeteve matëse të rrjedhjes së naftës
"Euro-Inspekt" N. SH.	Inspektimi i cilësisë së naftës dhe derivateve të naftës
"Energy Oil" SH.P.K.	Inspektimi i mjeteve matëse të rrjedhjes së naftës
"Adriainspekt Kosova" SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës
"Pasha Inspekt" SH.P.K.	Inspektimin i ashensorëve, vinçave dhe eskalatorëve
"GMC Kosova" SH.P.K	Inspektimin i ashensorëve, vinçave dhe eskalatorëve
"Coproni-I" SH.P.K.	Inspektimin i ashensorëve
"Ealga" N.SH.T.	Inspektimin i ashensorëve
"Petrol Company" SH.P.K.	Inspektimi për homologim të automjeteve të kategorive M1 dhe N1
"Sierra Lab" SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës, verifikimi i mjeteve matëse të rrjedhjes së naftës
"Olti" SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës
"Eurolab" SH.P.K	Inspektimi për homologim të automjeteve të kategorive L,M,N dhe O si dhe të gjitha nënkategoritë e tyre
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Inspektimi për homologim të automjeteve të kategorive: L (L <sub>1</sub> , L <sub>2</sub> , L <sub>3</sub> , L <sub>4</sub> , L <sub>5</sub> , L <sub>6</sub> , L <sub>7</sub> ), M1, N1, O1 dhe O2



*Për më shumë informacione, na kontaktoni në:  
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Rruga "Muharrem Fejza" p.n. Lagja Spitalit  
10000 Prishtinë/ Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 200 36 563  
<http://dak.rks-gov.net/>*